

**PROCEDURA PËR IDENTIFIKIMIN DHE PARANDALIMIN E SHFRYTËZIMIT TË  
PAAUTORIZUAR TË ENERGJISË TERMIKE**

**maj 2010**

faqe 1

Mbështetur në Nenin 29.3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Ngrohtorja e Qytetit “Termokos” sh.a Prishtinë, ka përgatitur Procedurën për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Termike.

## Neni 1

### Qëllimi

Qëllimi i kësaj procedure është t’u mundësojë punonjësve të autorizuar të Ngrohtores së Qytetit “Termokos” sh.a, që me kompetencë të ndërmarrin veprime për identifikimin, inspektimin, konstatimin, parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike, si dhe të ndërmarrin veprime për të realizuar kompensimin nga konsumatori për shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë termike.

## Neni 2

### Përkufizimet

2.1 Shprehjet e përdorura në këtë procedurë kanë kuptimin si në vijim:

“**Abuzim i njehsorit**” nënkupton shfrytëzimin e energjisë termike ashtu siç është përcaktuar në nenin 28.2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

“**Inspektim**” nënkupton kontrollimin e vendit të lidhjes, gypit për furnizim me energji termike, të pikës matëse dhe pajisjeve instaluese të konsumatorit.

“**Konsumator shtëpiak (familjar)**” nënkupton çdo person fizik që furnizohet me energji termike për konsum personal familjar.

“**Konsumator joshtëpiak - komercial e institucional (jo-familjar)**” nënkupton çdo person fizik apo juridik që shfrytëzon energjinë termike në hapësirat e dedikuara për qëllime biznesi dhe institucionale.



**“Konsumator”** nënkupton çdo person fizik apo juridik që shfrytëzon energjinë termike,

**“Kycje”** nënkupton lidhjen e objektit të konsumatorit në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike në bazë të kontratës së nënshkruar në mes të konsumatorit dhe furnizuesit të energjisë termike.

**“Kycje e paautorizuar”** nënkupton një kycje në mes të objektit të një konsumatori dhe rrjetit të shpërndarjes të energjisë termike, e cila nuk është e autorizuar ose e miratuar nga furnizuesi i energjisë termike.

**“Punonjës i autorizuar”** nënkupton personin që ka kontratë pune me furnizuesin dhe është i autorizuar për të bërë inspektimin e përdorimit të energjisë termike në objektet e të gjithë shfrytëzuesve të energjisë termike.

**“Shfrytëzimi i pakontraktuar i energjisë termike”** nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është e përcaktuar në Nenin 28.1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

**“Shkycje”** nënkupton ndërprerje fizike të një lidhjeje midis objektit të konsumatorit dhe rrjetit të shpërndarjes, që ekzekutohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes me kërkesë të Furnizuesit.

**“Vjedhje e energjisë termike ”** nënkupton shfrytëzimin e energjisë ashtu siç është përcaktuar në nenin 28.3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

2.2 Shprehjet tjera të përdorura në këtë procedurë do të ketë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Ngrahjen Qendrore dhe rregulloret në fuqi.

### **Neni 3**

#### **Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë termike**

Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë termike përfshin këto raste, por duke mos u kufizuar në:

- a) lidhje direkte në rrjetin primar të ngrohjes;
- b) lidhje në pjesën e rrjetit primar të nënstacionit termik;

- c) lidhje në sistemin sekondar të ngrohjes në gypat vertikale të katit të mëposhtëm;
- d) shpërndarje e ngrohjes prej një vertikale në tërë hapësirën ngrohëse;
- f) lidhje direkte në gypat horizontale të sistemit sekondar të ngrohjes;
- g) mungesë e bllobove (vulave) të N.Q. “Termokos” sh.a në njehsorë dhe atëherë kur këto vula janë të dëmtuara, të shoqëruara me prova faktike;
- h) dëmtim dhe largim të vulave të njehsorit të energjisë termike (matësit të energjisë termike), të shoqëruara me prova faktike;
- i) dëmtim të instalimeve të ngrohjes me qëllim të kycjes së paautorizuar;
- j) dëmtim fizik të njehsorit të energjisë termike;
- k) anashkalim të njehsorit të energjisë termike;
- l) shfrytëzim të energjisë termike në mënyrë të pakontraktuar sipas Nenit 28.1 të Rregullës mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si p.sh. dhënia e energjisë termike ndonjë konsumatori tjetër pa autorizim të N.Q. “Termokos” sh.a etj;
- m) Ndërrim të grupit tarifor (ndërrim destinimi të hapësirës ngrohëse nga ai banesor në biznes);
- n) Zgjerim të hapësirës ngrohëse në mënyrë të pakontraktuar;

#### **Neni 4**

##### **Identifikimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike**

4.1 Zbulimi dhe lajmërimi i dyshimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike është obligim i

- punëtorëve përgjegjës të rajonit përkatës (punonjës të N. Q. “Termokos” sh.a)
- inspektorëve në terren (punonjës të N. Q. “Termokos” sh.a ),
- inkasantëve, dhe
- punonjësve të shërbimit për konsumatorë,

4.2 Lajmërimi për dyshim të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike mund të bëhet edhe nga komuniteti, përfshirë edhe konsumatorët.

4.3 Me rastin e marrjes së informatave për dyshim të shfrytëzimit të paautorizuar sipas paragrafëve 4.1 dhe 4.2 të kësaj procedure, N. Q. “Termokos” SH.A do të ndërmarrë masat e menjëhershme operative , duke dërguar punëtorët e autorizuar në lokacionin e dyshuar për shfrytëzim të paautorizuar me qëllim të verifikimit dhe raportimit të rastit.

faqe 4



4.4 Punëtorët e autorizuar për verifikimin e kyçjeve ilegale dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë, kur kryejnë punë zyrtare, obligohen ta mbajnë me vete kartelën zyrtare e cila duhet të jetë në vend të dukshëm.

4.5 Parregullsitë sipas Nenit 3 të kësaj procedure që mund të vërehen lehtë nga punonjësit e NQ Termokos SH.A gjatë kryerjes së punëve të tyre të rregullta, e që nuk raportohen konsiderohen, shkelje e rëndë e detyrave të punës.

## **Neni 5**

### **Të drejtat e punonjësve të autorizuar**

5.1 Punonjësit e autorizuar për inspektim të shfrytëzimit të energjisë termike në objektin e konsumatorit kanë të drejtë:

a) të hyjnë në objektet e banimit në prani dhe me pëlqim të konsumatorit, për të inspektuar mënyrën e kyçjes në rrjetin e ngrohjes qendrore nga nënstacioni termik deri te trupat ngrohës, konform nenit 19.1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji,

b) të hyjnë në çdo kohë në ndërmarrje, institucione, lokale ose vende tjera, ku ushtrojnë veprimtarinë personat juridikë për të inspektuar shfrytëzimin e energjisë ngrohëse përkatësisht instalimet ngrohëse dhe pajisjet për matjen e energjisë termike,

c) të shkyçin objektin e konsumatorit nga furnizimi me energji termike për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar; shkyçja mund të bëhet në çdo kohë nga së paku dy punëtorë të autorizuar të N.Q. "Termokos" SH.A.

5.2 Në rast se konsumatori refuzon t'u lejojë qasjen në pronën apo në objektin e tij punonjësve të autorizuar të N.Q."Termokos" SH.A. për të inspektuar mënyrën e furnizimit me energji termike nga pika matëse deri te trupat ngrohës, atëherë mund të kërkohet asistencë nga organet kompetente të sigurisë për të kryer veprimin e planifikuar konform Nenit 22.3 të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

## **Neni 6**

### **Urdhëresa e punës**



6.1 Kur paraqiten raste sipas Nenit 4.3 të kësaj Procedure, Menaxheri i Departamentit të Shpërndarjes u lëshon urdhëresën e punës me shkrim, punonjësve të autorizuar të inspektimit.

6.2 Me urdhëresë verbale mund të veprohet vetëm në rastet kur:

- a) Menaxheri i Departamentit të Shpërndarjes kërkon që punonjësit e autorizuar të inspektimit të veprojnë në bazë të urdhëresës verbale të tij/saj;
- b) punonjësit e autorizuar gjatë orëve të punëve identifikojnë çfarëdo shfrytëzimi të paautorizuar të energjisë termike dhe nuk është e mundur të marrin urdhëresë me shkrim;
- c) aktiviteti i vërejtur paraqet rrezik për rrjetin e ngrohjes dhe që kërkon intervenim të menjëhershëm

6.3 Pas kryerjes së punës sipas rasteve si nën 6.2 a), b) dhe c), përgjegjësi i punonjësve të autorizuar plotëson urdhëresën e punës e cila i dorëzohet personit përgjegjës për aprovim dhe nënshkrim

6.4 Punonjësit e autorizuar të N.Q.”Termokos” SH.A gjatë inspektimit do t’i përmbahen Kodit të Etikës, Kodit të Qasjes në Tokë dhe Ndërtesa, përshkrimit të vendit të punës, procedurave të punës dhe udhëzimeve në urdhëresë të lëshuar nga udhëheqësi i tij/saj. Punonjësit e autorizuar duhet të prezantohen te konsumatori dhe të sqarojnë qëllimin e vizitës.

## **Neni 7**

### **Inspektimi i shfrytëzimit të energjisë termike**

7.1 Inspektimi i shfrytëzimit të energjisë termike përfshin këto raste, por duke mos u kufizuar në :

- a) Inspektimin e tërësishëm të instalimit të pajisjeve dhe rrjetit të ngrohjes në objektin e konsumatorit me qëllim të konstatimit të çfarëdo parregullsie në shfrytëzimin e energjisë termike dhe kyçjes në rrjetin e shpërndarjes, dhe
- b) Inspektimi i mënyrës së lidhjes dhe funksionimit normal të njehsorit të energjisë termike.



## Neni 8

### Pasaktësia në matje dhe verifikimi i njehsorëve të energjisë termike

8.1 Në rastet kur punonjësit e autorizuar dyshojnë se njehsori i energjisë termike nuk është duke regjistruar me saktësi të lejuar shfrytëzimin e energjisë termike, atëherë njehsori i energjisë termike duhet të zëvendësohet me një njehsor të ri, ndërsa njehsori i vjetër dërgohet për verifikim në laboratorin e kalibrimit kur një i tillë të jetë në dispozicion.

8.2 Mënyra e verifikimit të njehsorit nga laboratorin e kalibrimit është përcaktuar në udhëzimet administrative të lëshuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) si dhe në Kodin e Matjes.

8.3 Parregullsitë funksionale të njehsorit të energjisë termike siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) i kësaj Procedure të konstatuara në laboratorin e kalibrimit, nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur.

8.4 Procesverbali i plotësuar me konstatimet teknike nga punonjësit e laboratorit të kalibrimit të përcaktuara në paragrafin 8.3 dërgohet te komisioni i cili do të jetë i përbërë prej së paku tre anëtarëve : një nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh), kurse dy nga Furnizuesi. Veprimet të cilat do t'i ndërmarrë ky komision janë:

- a) analizon procesverbalin e ekipit të inspektimit i cili ka hequr njehsorin dhe procesverbalin e shërbimit të verifikimit dhe kalibrimit;
- b) analizon historikun e vendosjes së njehsorit, blerjen, montimin, inspektimin, listat e leximit etj;
- c) analizon profilin e konsumatorit, konsumin, pagesat;
- d) përgatit një raport në lidhje me këtë njehsor dhe në bashkëpunim me shërbimin për konteste, nëse vlerëson se konsumatori ka abuzuar njehsorin me qëllim të vjedhjes së energjisë, procedon lëndën e kompletuar te Shërbimi i faturimit për të përgatitur faturën për rikthimin e energjisë së humbur. NQ Termokos Sh.a përkatësisht Zyra Ligjore e saj , gjithashtu ka të drejtë të vendos gjokat sipas Tabelës së gjobave, si dhe të iniciojë procedurën e mëtejme gjyqësore.

## Neni 9

faqe 7



## **Veprimet pas konstatimit të shfrytëzimit të paautorizuar**

9.1 Veprimet që ndërmerren nga N.Q Termokos Sh.a me rastin e konstatimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike të pakontraktuar sipas Nenit3 të kësaj procedure janë:

- a) shkyç objektin e konsumatorit nga rrjeti i ngrohjes pas njoftimit paraprak të konsumatorit;
- b) plotëson procesverbalin dhe një kopje e dorëzon tek konsumatori; procesverbali përmban edhe udhëzimin për aplikim për legalizim të kyçjes ilegale apo shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike, e po ashtu duhet të përmbajë edhe udhëzimin për mundësinë e parashtrimit të ankesës brenda periudhës katërmëdhjetë (14) ditësh
- c) shkyç konsumatorin e rikyçur arbitrarisht me mundësi të heqjes së pajisjeve për furnizim me energji termike konform nenit 26 të Rregullës mbi shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë.

9.2 Nëse gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ekipi për inspektimin e shfrytëzimit të energjisë termike has në shfrytëzues të energjisë termike duke shfrytëzuar energjinë në mënyrë të paautorizuar sipas të Nenit 3 të kësaj procedure, atëherë ekipi zyrtar obligohet të kryejë veprimet e mëposhtme:

- a) përpilon procesverbalin në të cilin përshkruhet shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë termike;
- b) bën eliminimin e formës së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike.
- c) bën fotografimin e vendit që tregon mënyrën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike, që vërtetojnë faktet e shkruara në procesverbal;
- d) bën regjistrimin e të gjitha trupave ngrohës të instaluar që disponon konsumatori, sipërfaqes ngrohëse dhe të dhënave teknike të pikës matëse.
- e) harton procesverbalin në pesë (5) kopje: një kopje e mbajnë punonjësit e autorizuar të inspektimit, një kopje i dorëzohet-i/lihet konsumatorit kurse nga një kopje u dërgohet Shërbimit për Faturim, Shërbimit për Konsumatorë dhe Departamentit të Shpërndarjes. Procesverbali do të hartohet në gjuhën shqipe. Në rast të kërkesës së konsumatorit, N.Q. “Termokos” SH.A do të sigurojë procesverbalin edhe në një nga gjuhët zyrtare të kërkuar nga konsumatori.



9.3 Në rastet kur ekipi për inspektim has në shfrytëzues të energjisë termike të cilët kanë abuzuar me njehsorë të energjisë termike sipas pikave (g,h,j,k) të Nenit 3 të kësaj procedure obligohet të kryejë veprimet e mëposhtme:

- a) Shkyç furnizimin me energji termike dhe largon njehsorin e energjisë termike në të cilin janë konstatuar gjurmë abuzimi,
- b) Regjistron hapësirën ngrohëse, numrin dhe të dhënat për trupat ngrohës të instaluar , numrin dhe gjendjen e matësit (njehsorit) të energjisë, si dhe një kopje të këtij procesverballi ia dorëzon konsumatorit,
- c) Vendos tjetër njehsor të energjisë në afat jo më vonë se njëzetëekatër (24) orë nga koha e largimit të njehsorit të energjisë.

## **Neni 10**

### **Formulari i procesverballit**

10.1 Me rastin e inspektimit, punonjësit e autorizuar të N.Q. “ Termokos”sh.a do të plotësojnë formularin standard të raportimit. Kopja e formularit raportues paraqitet në Shtojcën 2 të kësaj procedure.

10.2 Procesverballi duhet të plotësohet tek vendi i ndodhjes së shfrytëzimit të paautorizuar të Energjisë termike dhe në prezencën e shfrytëzuesit të energjisë termike ose të ndonjë anëtari të familjes së shfrytëzuesit të moshës madhore, përveçse në rrethanat e pengimit (p.sh. në rastet e kërcënimit).

Procesverballi duhet të përmbajë këto të dhëna:

- a) Datën e përpilimit dhe numrin rendor të procesverballit;
- b) Për konsumatorët familjarë: emrin, mbiemrin, adresën e vendbanimit dhe numrin personal të shfrytëzuesit, si dhe shifrën e konsumatorit.



- c) Për konsumatorët jofamiljarë: emrin e biznesit, emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të autorizuar të konsumatorit jofamiljar, numrin personal të tij, adresën e lokacionit, llojin e biznesit, numrin e regjistrimit të biznesit, dhe shifrën e konsumatorit;
- d) Përshkrimin e qartë, të saktë dhe të kompletuar të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike ;
- e) Përshkrimin e veprimeve të ndërmarra pas konstatimit për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë termike: evidentimi i saktë i të gjitha pajisjeve ngrohëse që posedon konsumatori në momentin e plotësimit të procesverbalit dhe shkyçjes nga rrjeti.
- f) Nënshkrimin e shfrytëzuesit të paautorizuar të energjisë termike; Refuzimi eventual për t'u nënshkruar do të shënohet në procesverbal; si dhe
- g) Përshkrimin e detajuar në rast të kërcënimit, pengimit apo dhunës eventuale ndaj punonjësve të autorizuar, së bashku me çfarëdo të dhënash personale të cilat mund të merren nga personi (personat) që ushtrojnë kërcënimin, pengimin apo dhunën.

## **Neni 11**

### **Marrja e fotografive (dëshmime)**

Punonjësit e autorizuar të N.Q. "Termokos" SH.A duhet të bëjnë fotografi nga vendi i ndodhjes së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike dhe varësisht nga rrethanat të sigurojnë edhe prova tjera që i bashkëngjiten procesverbalit.

Fotografitë duhet:

- a) të paraqesin informatat të cilat identifikojnë vendin e ndodhjes (p.sh. objekti, numri i ndërtesës dhe emri i rrugës);
- b) të paraqesin orarin e punës të konsumatorët komercialë, nëse ka;
- c) të jenë të qarta dhe të lexueshme;
- d) të paraqesin mënyrat e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike; si dhe
- e) të paraqesin numrin e njehsorit, gjendjen faktike të gjendjes së njehsorit dhe tiketën që tregon datën e vulosjes.

## **Neni 12**



## **Shqyrtimi dhe Verifikimi i procesverbaleve nga Zyra ligjore**

12.1 Procesverbali i përgatitur sipas Nenit 10 të kësaj procedure dhe dëshmitë tjera të marra nga vendi i ndodhjes, do të dorëzohen me letër përcjellëse në Shërbimin për Konsumatorë i cili vepron në kuadër të Departamentit të Furnizimit të NQ Termokos Sh.a.

Nga Shërbimi për Konsumatorë kompletohet lënda me të gjithë dokumentacionin përkatës, dhe në bashkëpunim me Zyrën ligjore vendoset nëse ka bazë ligjore për ushtrim të kallëzimit penal apo ndërmarrjes së veprimeve të tjera të nevojshme për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë termike.

12.2 Nëse Shërbimi për Konteste / Zyra Ligjore konstaton se lënda nuk është e kompletuar, ka ndonjë paqartësi (mangësi), atëherë lënda duhet të kthehet te Shërbimi për Konsumatorë për korrigjim dhe kompletim adekuat. Nëse konstatohet që procesverbali nuk është i kompletuar, atëherë duhet të bëhet ekzaminimi shtesë dhe duhet të zbatohen procedurat e njëjta si gjatë inspektimit të parë. Pas kësaj ndiqet procedura sipas nenit 12.1.

### **Neni 13**

#### **Llogaritja e sasisë së energjisë termike të shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar dhe faturimi**

13.1 Nëse fillimi i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike sipas Nenit 9.2 dhe 9.3 të kësaj procedure nuk mund të përcaktohet, atëherë për konsumatorët shtëpiakë (familjarë) do të merret që shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë termike ka filluar për periudhën kohore që përfshinë një sezonë të ngrohjes. Ndërsa për konsumatorët joshtëpiakë (jofamiljarë) do të merret që shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë termike ka filluar për periudhën kohore që përfshinë dy sezona të ngrohjes, para datës kur konsumatori është zbuluar.

13.2 Llogaritja e sasisë së energjisë termike të shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar, për konsumatorët pa matje, bëhet duke matur sipërfaqen e hapësirave në të cilat ndodhën trupat ngrohës në momentin e inspektimit.

13.3 Llogaritja e sasisë së energjisë termike të shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar, për konsumatorët me matje bëhet duke regjistruar kapacitetin e trupave ngrohës dhe duke e shumëzuar me

faqe 11



kohën e shfrytëzimit (kohëzgjatja ditore e furnizimit me ngrohje) [orë/muaj].

13.4 Nga sasia e energjisë së shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar, e cila përcaktohet nga Departamenti i Faturimit, duhet të zbritet sasia e energjisë termike që është faturuar/regjistruar në njehsor gjatë asaj periudhe.

13.5 Në rastet kur ekipeve të autorizuara nuk iu lejohet qasja në ndërtesa për sigurimin e shënimeve të sipërfaqes ngrohëse në të cilat janë të instaluar trupat ngrohës, llogaritja e shpenzimit do të bëhet:

- a) sipas sipërfaqes së banesës së katit të mëposhtëm apo katit të sipërm (për konsumatorët në ndërtesat kolektive),
- b) sipas sipërfaqes në bazë të matjes së mureve të jashtme të objektit (për konsumatorët në shtëpi private, objekte komerciale ose institucionale), si dhe
- c) Sipas kapacitetit të shkëmbyesve në nënstacion ose sipas kapacitetit të pëlqimit termo-energjetik

13.6 Për llogaritjen e faturave për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë termike do të zbatohen tarifat e aplikueshme në datën kur është identifikuar shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë termike. Për konsumatorët shtëpiakë (familjarë) do të zbatohen tarifat e grupit të konsumatorëve shtëpiakë (familjarë), kurse për konsumatorët joshtëpiakë (komerciale dhe institucionale) do të zbatohet tarifa e përcaktuar për konsumatorët komerciale e institucionale.

13.7 Përveç pagesës retroaktive sipas dispozitës 13.1 shfrytëzuesi i paautorizuar i energjisë termike, gjobitet sipas taksave dhe gjobave të përcaktuara në pajtim me Rregullin për Shkyçjen dhe Rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë, të aprovuar nga ZRRE.

13.8 Përveç llogaritjes së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike, konsumatorët e të gjitha grupeve të konsumatorëve mund të ngarkohen edhe me: pagesën për shkyçje dhe rikyçje, gjoba, pagesën për ndërrimin e njehsorit, pagesën për angazhimin e palës së tretë dhe shpenzimet e padisë gjyqësore.

13.9 Në rastet kur shfrytëzuesi i paautorizuar i energjisë termike lajmërohet vetë dhe kërkon legalizimin e kyçjes, në këtë rast nuk shqiptohet gjoba, por vetëm faturimi retroaktiv.

## **Neni 16**

### **Dorëzimi i Faturës**

Faturën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë termike, Furnizuesi obligohet t'ia dërgojë konsumatorit në afatin sa më të shkurtër, e më së largu deri në tetë (8) ditë kalendarike pas përpilimit të procesverbalit.

## **Neni 17**

### **Ankesat e konsumatorëve**

17.1 Konsumatori ka të drejtë që ta kundërshtojë faturën e rikthimit të energjisë së humbur, në afat prej katërbëdhjetë (14) ditësh kalendarike pas marrjes së faturës nga Furnizuesi.

17.2 Ankesat e konsumatorëve do t'i shqyrtojë një panel i brendshëm i përbërë prej tre \_\_\_\_ anëtarëve: një anëtar do të jetë nga Zyra ligjore, një nga Shërbimi i faturimit dhe një nga Shërbimi i kujdesit ndaj konsumatorit.

17.3 Paneli do të shqyrtojë ankesat e konsumatorëve në përputhje me Rregullën mbi Procedurën për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë dhe me procedurat e brendshme të N.Q. "Termokos" Sh.a.

17.4 Afati i dhënies së përgjigjes nga Furnizuesi në ankesën e konsumatorit nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së regjistrimit të ankesës së konsumatorit.

17.5 Furnizuesi duhet të posedojë dëshmi që konsumatori e ka marrë përgjigjen në ankesë.

17.6 Përgjigja duhet të përmbajë udhëzimin për konsumatorin mbi të drejtën e tij për të paraqitur apel në ZRRE, në afatin prej katërbëdhjetë (14) ditësh kalendarike, kundër përgjigjes së dhënë nga N.Q. "Termokos" SH.A, konform nenit 9.3. shkronjës (e) dhe nenit 13.1 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.



17.7 N.Q. “Termokos” SH.A, mund të mos fillojë procedurë gjyqësore përderisa kontesti civil është në proces në ZRRE, duke përfshirë raste kur palët për zgjidhjen e kontesteve kanë përdorur Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ZAK), sipas nenit 20 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

## **Neni 18**

### **Gjuha zyrtare**

Kjo Procedurë nxirret në gjuhën shqipe, dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

## **Neni 19**

### **Hyrja në fuqi**

19.1 Kjo Procedurë hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji.

19.2 N.Q Termokos mund të propozojë ndryshimin e kësaj Procedure kohë pas kohe, ndërsa ndryshimet duhet të aprovohen nga ZRRE.

## **Shtojca 1.**

1. Formulari i procesverbalit të punonjësve të autorizuar

**Nga: Inspektorët për Verifikimin e shfrytëzimit të paautorizuar dhe Ankesave në Terren,  
Departamenti i Furnizimit - N.Q. “TERMOKOS” Sh. a., Prishtinë**

faqe 14



Për konsumatorin (Emri & Mbiemri): _____;
Adresa: _____;
Data: ___/___/____;
Lënda: PROCESVERBAL

### PROCESVERBAL

Inspektorët për Verifikimin e shfrytëzimit të paautorizuar dhe Ankesave në terren të N.Q.

“TERMOKOS” Sh.A., pas verifikimit në terren identifikuan këto të dhëna:

• <b><u>IDENTIFIKIMI I SHFRYTËZIMIT TË PAAUTORIZUAR TË ENERJISË TERMIKE</u></b>		<input type="checkbox"/>
SEKTORI I AMVISËRISË	<input type="checkbox"/>	GJENDEN TRUPAT NGROHËS <input type="checkbox"/>
SEKTORI AFARIST	<input type="checkbox"/>	NUK GJENDEN TRUPAT NGROHËS <input type="checkbox"/>
KA NGROHJE <input type="checkbox"/>		NUK KA NGROHJE <input type="checkbox"/>
SIPËRFAQJA NGROHËSE NË M <sup>2</sup>		M <sup>2</sup>
• <b><u>NDËRRIM DESTINACIONI</u></b>		<input type="checkbox"/>
NGA:	SEKTORI I AMVISËRISË	<input type="checkbox"/>
	SEKTORI AFARIST	<input type="checkbox"/>
NË:	SEKTORI I AMVISËRISË	<input type="checkbox"/>
	SEKTORI AFARIST	<input type="checkbox"/>
• <b><u>NDRYSHIMI I SIPËRFAQES NGROHËSE NË M<sup>2</sup></u></b>		<input type="checkbox"/>
SIPËRFAQJA E FATURUAR DERI MË TANI:		M <sup>2</sup>
RRITJE E SIPËRFAQES NGROHËSE:		<input type="checkbox"/>
ZVOGËLIM I SIPËRFAQES NGROHËSE:		<input type="checkbox"/>
SIPËRFAQJA NGROHËSE E VERFIKUAR PAS MATJES:		M <sup>2</sup>
• <b><u>NDËRRIMI I PRONARIT</u></b>		<input type="checkbox"/>
NGA:	EMRI I KONSUMATORIT I CILI FATUROHET:	

<b>NË:</b>	<b>EMRI I PRONARIT TË RI:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b><u>TË TJERA</u></b></li> </ul>	<input type="checkbox"/>
<hr/> <hr/>	

N.Q.“TERMOKOS” Sh.a.

**Konsumatori:**            **Inspektorët për Verifikimin e Kyçjeve të Reja dhe Ankesave në Terren**

\_\_\_\_\_ 1. \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

(emri & mbiemri)                      (emri & mbiemri)            (nënshkrimi)

\_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_

(nënshkrimi)            (emri & mbiemri)            (nënshkrimi)

2. Vërejtja - **Për moslejim të qasjes së punonjësve të autorizuar në ndërtesën /objektin e konsumatorit**

<b>Nga:</b> <u><b>Inspektorët për Verifikimin e Shfrytëzimit të paautorizuar dhe Ankesave në Terren,</b></u> <b>Departamenti i Furnizimit - N.Q. “TERMOKOS” Sh. a., Prishtinë</b>
<b>Për konsumatorin (Emri &amp; Mbiemri):</b> _____;
<b>Adresa:</b> _____;
<b>Data:</b> ___/___/_____
<b>Lënda: VËREJTJE</b>

## VËREJTJE

**Për moslejim të qasjes së punonjësve të N.Q Termokos në pronën tuaj**

**Inspektorët për Verifikimin e Shfrytëzimit të paautorizuar dhe Ankesave në Terren të N.Q Termokos Sh.a.** Ne punonjësit e N.Q Termokos sh.a zyrtarisht kemi qenë disa herë në banesën/lokalin tuaj dhe gjatë kësaj kohe, ju nuk na keni lejuar dhe nuk jeni lajmëruar asnjëherë për të na lejuar qasje për të verifikuar trupat ngrohës dhe sipërfaqen e saktë të ngrohjes në banesën/lokalin tuaj. Ky inspektim bëhet me qëllim të regjistrimit dhe verifikimit të të dhënave faktike, identifikimit të trupave ngrohës,

faqe 16





përshkrimit të destinacionit si dhe matjen e sërishme për verifikimin e saktë të sipërfaqes ngrohëse.

**Bazuar në Ligjin për Energjinë 2004/8 (Nenin 28) dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, (Nenin 19 Qasja në Pronë), jeni të obliguar që t’u lejoni qasje në pronën tuaj Inspektorëve të terrenit të autorizuar nga N.Q. “TERMOKOS”Sh.a. për të verifikuar sipërfaqen ngrohëse, si dhe trupat ngrohës në hapësirën tuaj.**

Kjo është vërejtja e fundit, përmes së cilës iu paralajmërojmë se do të merren masa të tjera për të na lejuar qasje në pronën tuaj, në raste të nevojshme edhe me përcjellje të shërbimit policor.

Për të gjitha informatat si dhe paraqitjen tuaj për të na lejuar qasje në pronën tuaj, iu këshillojmë të adresoheni në lokalet e N.Q. “TERMOKOS” Sh.a., Dardania, p.n., përkatësisht në Departamentin e Furnizimit.

**N.Q.“TERMOKOS” Sh.a.**

**Inspektorët për Verifikimin e Shfrytëzimit të paautorizuar dhe Ankesave në Terren**

1. \_\_\_\_\_,  
(emri & mbiemri) (nënshkrimi)
2. \_\_\_\_\_,  
(emri & mbiemri) (nënshkrimi)
3. Formulari për ndërrimin e emrit të pronarit,

